

VENDIM
Nr. 952, datë 12.12.2012

**PËR PËRJASHTIMIN E PROFESIONISTIT NGA DETYRIMI PËR DHËNIEN E PROVIMIT TË
SHTETIT PËR PROFESIONET E RREGULLUARA**

Në zbatim të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 9 të ligjit nr. 10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfashtimin nga detyrimi për dhënie e provimit të shtetit të profesionistit, i cili ka fituar të drejtën e ushtrimit të njërit prej profesioneve të rregulluara, të parashikuara në nenin 5 të ligjit nr. 10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ose ka përfunduar me sukses provimin e shtetit, në një nga vendet e mëposhtme:

- a) Vendet anëtare të Bashkimit Europian;
- b) Vendet e EFTA-s (Shoqata Europiane për Tregtinë e Lirë): Zvicër, Lihtenshtein, Norvegji, Islandë;
- c) Vendet me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje dypalëshe për këtë qëllim;
- ç) Shtetet e Bashkuara të Amerikës;
- d) Kanada;
- dh) Japoni.

2. Profesionisti, që përfiton nga përcaktimi i pikës 1 të këtij vendimi, duhet të ketë përfunduar arsimin universitar përkatës, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë.

3. Profesionisti aplikon për regjistrim për ushtrim të profesionit të rregulluar në Republikën e Shqipërisë pranë urdhrave profesionalë përkatës dhe, në mungesë të tyre, pranë autoritetit kompetent. Pas shqyrtimit të aplikimit, kur plotësohen kriteret e pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, urdhri profesional përkatës ose, në mungesë të tij, autoriteti kompetent, kryen regjistrimin e profesionistit.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe autoritetet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha